



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:120119

Datë: 12.08.2022

Numri i dokumentit: 03322724

P.nr. 230/22

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE DEGA NE VUSHTRRI, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Nazmije Maxhera, ne lenden penale kundër te akuzuarve Sh. Sh. F. Sh. B. Sh., dhe Sh. Sh. nga fshati P. komuna e V. ku edhe jetojnë, për shkak te veprës penale “Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 e 2 te KPK-se, Pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 316 par 3 te KPK-së dhe “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 153 par 1 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut tani Prokurorisë Themelore ne Mitrovice , Departamenti i Përgjithshëm PP.nr. 376/2009 te dt. 17.05.2012, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar te mbajtur me dt. 10.08.2022 morri dhe publikisht shpalli, kurse me dt. 12.08.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

- **Sh. Sh.**, nga i ati I., dhe e ëma N., e gjinisë I. i lindur më ..., në fshatin P. Komuna e V., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit- ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë;
- **F. Sh.** nga i ati I. dhe e ëma N. e gjinisë I. i lindur më ... në fshatin P. Komuna e V., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit-..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë;
- **B. Sh.** nga i ati I., dhe e ëma N., e gjinisë . i lindur më, në fshatin P. Komuna e V. ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë;
- **Sh. Sh.** nga i ati I.dhe e ëma N. e gjinisë I. i lindur më ..., në fshatin P. Komuna e V. ku edhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovë,

I akuzuari i parë **Sh. Sh.**

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

- I.** 1. Me datë 11.10.2009, rreth orës 14.35 minuta, në fshatin P. – V. ka përdorur armën me kërcënim ndaj te dëmtuarve – policëve te stacionit policor ne V. I. R. M. R. dhe A. Sh.ne ate menyre qe pasi policet kane shkuar per shkak te mosmarrëveshjes ne mes te familjes se te pandehurit dhe familjes se te dëmtuarit A. Sh. dhe policet kane kërkuar nga i pandehuri Sh. Sh. qe te shkoj ne stacion policor për intervistim, i

pandehuri ka vrapuar ne drejtim te shtëpisë – ka hyre brenda ne shtëpi pastaj ka dal me arme ne dore – armen automatike C, – .. -... e kalibrit ... mm ne te cilën ka pasur ..fishek dhe armen iu ka drejtuar policëve edhe te dëmtuarit A. Sh. dhe me zë te larte ka bërtitur “largohuni ju se pa e vra se lëshojë” me qe rast policet kane reaguar, kane nxjerr armët, e kane larguar te dëmtuarin A.Sh. kanë vazhduar ne drejtim te te pandehurit i cili ka ikur nga vendi i ngjarjes.

Me këtë ka kryer veprën penale “**Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve**” nga neni 328 par.1 te KPK-se.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 11, 34, 38, 65 të KPRK –së dhe në bazë të nenit 328 par.1 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365,370, të KPPRK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin **Sh. Sh.** me dënim me burg, në kohëzgjatje prej tre (3) muaj.

Me pëlqimin e të pandehurit, e konfom nenit 38 par.3 dhe nenit 40 të KPK-së:

DËNIMI me burg ne kohëzgjatje prej gjashtë (3) muaj, nuk do të ekzekutohet pasi që me pëlqimin e të akuzuarit, gjykata i ka zëvendësuar dënimin e shqiptuar me burg në dënim me 240 (dyqindedyzet) orë pune pa pagesë te cilat do ti kryej ne afat prej 1 viti.

- a) Shërbimi Sprovues do të mbikëqyr zbatimin e dënimit për punë me dobi të përgjithshme, do të përcaktoj llojin e punës me dobi te përgjithshme, do të caktoj organizatën ku do të kryhet puna me dobi të përgjithshme si dhe të vendos për ditët e javës gjate te cilave puna me dobi te përgjithshme do te kryhet. Urdhërohet i akuzuari Shaban Shabani qe te mbaje kontakte me Shërbimin Sprovues deri ne përmbushjen e plote të dënimit prej 240 ore pune pa pagese ne dobi te përgjithshme ne kohëzgjatje prej një viti.
- b) Ne qofte se i akuzuari nuk e kryen punën ne dobi te përgjithshme, Gjykata mund ta revokojë urdhrin për zëvendësimin e dënimit me burg.
- c) Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 30€ (tridhjetë) euro, dhe në emër të pagesës për kompensimin e viktimave të krimit 30€ (tridhjetë euro).

Për veprën penale sipas pikës 2 te aktakuzës ndaj te pandehurit Sh. Sh. pas tërheqjes se prokurorisë:

HUDHET AKTAKUZA

Sepse prej pas lufte te vitit 1999, e deri me dt. 11.10.2009, ne shtëpinë e tije ne fshatin P. komuna e V. pa leje valide për mbajtjen e armës te lëshuar nga organi kompetent, ka mbajtur ne pronësi armen – pushkën automatike C.... – .. -... e kalibrit ... mm me numër serik ..., me karikator me .. fishek te te njëjtit kalibër te cilat i janë konfiskuar nga policia,

Me këtë kishte për te kryer veprën penale Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.2 te KPK-se.

Për pikën 3 te aktakuzës lidhur me te pandehurin Shaban Shabani duke qene se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale:

HUDHET AKTAKUZA

3. Me datën kohën dhe vendin si në piken 1 të aktakuzës është kanosur seriozisht me përdorimin e armës se do të sulmojë personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare të ruajtjes së rendit publik dhe atë policet e stacionit policor në V. si në piken 1, të dispozitivit, në atë mënyrë që pasi policet kanë arritur ta arrestojnë të pandehurin B. Sh., i cili është goditur me grushta në fytyrë A. Sh. i pandehuri Sh.Sh. iu është kanosur policeve me fjalët: “ndalë se po shkoj e pe marr kallashin e ju kallëzoi këtyre”

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317 par 2 të KPK-së.

I. I akuzuari i dytë F. Sh.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse: 1. Me datë kohën dhe vendin si në piken I. 1 të dispozitivit e përdorur armen në kërcënim ndaj të dëmtuarve policëve të stacionit policor në V. I.R., M. R. dhe A. Sh. në atë mënyrë që ua ka drejtuar armen automatike C. .. – .. -.. e kalibrit ... mm në të cilën ka pasur .. fishek e cila armë iu është konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë ka kryer veprën penale “Mbajtje në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 të KPK-se.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 11, 34, 38, 65, 67 dhe në bazë të nenit 328 par.1 të KPK-së, si dhe në bazë të neneve 365,370, të KPPRK-së,

G J Y K O N

Të pandehurin **F. Sh.** me dënim me burg, në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Me pëlqimin e të pandehurit, e konfom nenit 38 par.3 dhe nenit 40 të KPK-së:

DËNIMI me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (3) muaj, nuk do të ekzekutohet pasi që me pëlqimin e të akuzuarit, gjykata i ka zëvendësuar dënimin e shqiptuar me burg në dënim me 240 (dyqindëdyzet) orë pune pa pagesë të cilat do të kryejnë në afat prej 1 viti.

- d) Shërbimi Sprovues do të mbikëqyr zbatimin e dënimit për punë me dobi të përgjithshme, do të përcaktoj llojin e punës me dobi të përgjithshme, do të caktoj organizatën ku do të kryhet puna me dobi të përgjithshme si dhe të vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna me dobi të përgjithshme do të kryhet. Urdhërohet i akuzuari Fitim Shabani që të mbajë kontakte me Shërbimin Sprovues deri në përmbushjen e plote të dënimit prej 240 orë pune pa pagesë në dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej një viti.
- e) Në qoftë se i akuzuari nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, Gjykata mund ta revokojë urdhrin për zëvendësimin e dënimit me burg.
- f) Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë) euro, dhe në emër të pagesës për kompensimin e viktimave të krimit 30€ (tridhjetë euro).

Për veprën penale sipas pikës II/ 2 të aktakuzës ndaj të pandehurit Fitim Shabani pas tërheqjes së prokurorisë:

HUDHET AKTAKUZA

Sepse prej pas lufte te vitit 1999, e deri me dt. 11.10.2009, ne shtëpinë e tije ne fshatin P.komuna e V. pa leje valide për mbajtjen e armës te lëshuar nga organi kompetent, ka mbajtur ne pronësi armen – pushkën automatike C. ...– .. -.. e kalibrit ... mm me numër serik ..., me karikator me ..fishek te te njëjtit kalibër te cilat i janë konfiskuar nga policia,

Me këtë kishte për te kryer veprën penale: **Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.2 te KPK-se.**

Për piken III te aktakuzës lidhur me te pandehurin F. Sh. B. Sh. dhe Sh. Sh. duke qene se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale:

HUDHET AKTAKUZA

Sepse 3. Me datën kohen dhe vendin si ne piken I/1 te aktakuzës se bashku me dhune kane penguar personat zyrtar gjatë kryerjes se detyrës zyrtare te ruajtjes se personit te privuar nga liria ashtu qe kur policët si ne piken I/ 1 te dispozitivit e kane arrestuar te pandehurin Sh. Sh. te pandehurit se bashku kane ndërhy dhe me dhune i kane penguar policet me që rast i pandehuri Sh. Sh. ka arrit te iki nga policia,

Me këtë kishin për te kryer veprën penale Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 316 par 3 te KPK-së.

VI. Ndaj te pandehurit Bekim Shabani për shkak të arritjes se parashkrimit absolut te ndjekjes:

HUDHET AKTAKUZA

Sepse VI/I pandehuri B. Sh. Me datën kohen dhe vendin si ne piken I/1 te aktakuzës i ka shkaktuar lëndime te lehta trupore te dëmtuarit I.Sh. ashtu qe me grushte e ka goditur ne fytyrë dhe nofull te majtë duke i shkaktuar skuqje dhe te ajur,

Me këtë kishin për te kryer veprën penale Lëndim i lehte trupor nga neni 153 par 1 te KPK-së.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.

Arma e përdorur – pushka automatike e C.... .. e kalibrit ... me numër serik ...se bashku me .. fishek, konform dispozitave te nenit 328 par 5 te KPK-së, konfiskohet.

Detyrohen të akuzuarit që secili veç e veç që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën prej nga **30€ (tridhjetë/euro)**, dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit secili të paguaj shumën prej nga **30€ (tridhjetë euro)**. **Te gjitha** brenda afatit prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të behët i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike të Qarkut tani Prokuroria Themelore ne Mitrovice , Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.nr. 376/2009 te dt. 17.05.2012, kundër të akuzuarve: Sh.

Sh. F. Sh. B. Sh. dhe Sh. Sh. nga fshati P. komuna e V. ku edhe jetojnë, për shkak të veprës penale “Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 e 2 të KPK-se, Pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 316 par 3 të KPK-së dhe “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 153 par 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar 01.02.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit, të akuzuarve Sh. Sh. e F. Sh. Ndaj te pandehurve Sh.Sh. e F. Sh. për veprat penale si ne piken I/2 e II/2 të dispozitivit të aktakuzës Gjykata duke e konsideruar parashtresën e Prokurorisë Themelore PP.I. 376/2009 nga dt. 07.03.2016, e ka hudhë akuzën duke qene se për këtë janë plotësuar edhe kushtet ligjore ne vështrim të dispozitave të nenit 3 par 1 nenpar. 1.2 pika 1.2.5 të Ligjit për amnisti Ligji nr. 2013/04-L-209 dhe neni 253 të KPP-së pasi qe aktakuza ka mbet pa objekt për shkak të tërheqjes se prokurorit.

Sa i përket veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 317 par 2 të KPK-së për te cilën ishte akuzuar i pandehuri Sh. Sh. si **ne piken I/3** të aktakuzës gjykata

ka konstatuar se nga koha e kryerjes së veprës penale të datës 11.10.2009, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në kuptim të nenit 90 par.1 nën par. 4 të KPK-së, që është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), andaj në kuptim të nenit 253 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së, është hudhur aktakuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Sa i përket **pikës III** të aktakuzës lidhur me te pandehurit F. Sh. B. Sh. dhe Sh. Sh. te dyshuar për veprën penale Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 316 par 3 të KPK-së, gjykata ka konstatuar se nga koha e kryerjes së veprës penale të datës 11.10.2009, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në kuptim të nenit 90 par.1 nën par. 4 të KPK-së, që është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), andaj në kuptim të nenit 253 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së, është hudhur aktakuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Sa i përket pikës IV të aktakuzës kundër te pandehurit Sh. Sh. i dyshuar për veprën penale Lëndim i lehte trupor nga neni 153 par 1 të KPK-së gjykata ka konstatuar se nga koha e kryerjes së veprës penale të datës 11.10.2009, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në kuptim të nenit 90 par.1 nën par. 4 të KPK-së pasi ka kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit andaj gjykata për këtë pike të aktakuzës e ka hudhur aktakuzën ne kuptim të dispozitave të nenit 253 par 1 të KPP-së.

Lënda gjyqtarit te vetëm gjykues i është ndarë me dt. 17.12.2017, pasi ka arritur parashkrimi relativ për veprat penale te përshkruara si ne piken I/3; III; e IV të dispozitivit të aktakuzës pasi që nga ngritja e aktakuzës me dt. 17.05.2012, përpos komunikimit intern nuk është ndërmarr asnjë veprim.

Shqyrtimi fillestarë ka vazhduar kundër të akuzuarve Sh. Sh. e F. Sh. për veprën penale “Mbajtje ne pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Ne këtë çështje penale kjo gjykatë ka vendosur me aktgjykimin P nr. 219/2016 nga dt. 09.02.2022, i cili aktgjykim është anuluar me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit PA1 nr. 475/2022 nga dt. 17.05.2022, me rekomandimin qe kjo gjykatë te ne rigjykim te siguroi mbrojtës për te pandehurit, *pasi mbrojtja është e detyrueshme dhe me rekomandimin qe ne rigjykim te merren*

parasysh edhe pretendimet e mbrojtësit sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, me rastin e vendosjes meritorisht në këtë çështje penale.

Ne rigjykim, në zbatim të rekomandimeve të gjykatës së Apelit kjo gjykatë ka caktuar dhe mbajtur në seancën e dt. 10.08.2022 ku fillimisht ka siguruar prezencën e mbrojtësve të pandehurve dhe atë për të pandehurin Sh. Sh. av. Abit Asllani mbrojtës sipas autorizimit dhe për të pandehurin F. Sh. mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Lirim Perçuku, ku gjykata të pandehurve iu ka lexuar aktakuzën dhe të pandehurit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe pasi që gjykata u bind se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën ka ftuar të pandehurit që të deklarohen mbi fajësinë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, **i pandehuri i parë Sh. Sh.** ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale “Mbajtje në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 të KPK-se e cila i vihet në barre dhe e ka pranuar fajësinë.

I pandehuri Sh. Sh. ka theksuar se i vije keq për atë që ka ndodhur dhe ajo ka ndodhur aty për aty, ka qenë e çastit, nuk e dinë se si ka ardhur ai problem, sepse ka shumë respekt për Policinë e Kosovës dhe do të ishte në gjendje që vetë ta mbroj shtetin, por që në atë rast nuk ishte lënduar askush. Ka shtuar se janë katër vëllezër, e kanë krijuar një lloj firme të vogël dhe punojnë me pllaka dhe me atë punë e mbajnë familjen, dhe vete janë të gjithë të angazhuar në atë punë. Ka theksuar se në të ardhmen nuk pritet që të bëjë veprime të tilla, dhe me policet e dëmtuar flasin, u kanë kërkuar falje, të njëjtit e kanë pranuar kërkim faljen dhe pse kanë kaluar 12-13 vite nga rasti që ka ndodhur.

Mbrojtësi i të pandehurit Sh. Sh. av. Abit Asllani lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se me qene se i mbrojturi i tije vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e ka pranuar fajësinë pa kurrfarë ndikimi, duke i pasur të njohura edhe benefitet e pranimin të fajësisë ashtu edhe ai si mbrojtës i ishte bashkëngjitur atij pranimi të fajësisë. Ka theksuar se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë mbi dymbëdhjetë vite, ky kalim i kohës e ka zhvlerësuar edhe veprën penale duke i propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese dhe të shqiptoj një sanksion penal të kushtëzuar, e duke konsideruar rrethanat materiale të të pandehurit të shqiptoi eventualisht një dënim me punë me interes të përgjithshëm.

Edhe i pandehuri i dytë **F. Sh.** ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale “Mbajtje në pronësi kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve” nga neni 328 par.1 të KPK-se.

I pandehuri F. Sh. ka theksuar se është njësoj i penduar sikurse vëllai i tij i cili u deklarua, se i vije keq për atë se çka ka ndodhur dhe se në të ardhmen do të ketë më tepër kujdes që të mos ketë situata të ngjashme.

Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh. Av. Lirim Perçuku ka theksuar se pas konsultimeve të mjaftueshme ka parë vullnetin e të pandehurit që ta pranojë fajësinë sipas aktakuzës, pasi që ashtu del edhe nga faktet e aktakuzës, kurse gjykatën e ka lutur që me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe që konform dispozitave të KPK së të behet lirimi nga dënimi i të pandehurit e në rast se gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për lirimin nga dënimi, të ju shqiptoi një dënim të kushtëzuar duke konsideruar se të pandehurit kanë pas pasoja gjatë gjithë këtyre viteve pasi kanë qenë në evidencë penale dhe nuk kanë mund të sigurojnë certifikatën nën hetime të pastër dhe se as një dënim nuk do të ishte i barabartë me këto pasoja.

Gjyqtari i vetëm gjykues ne rigjykim te pandehurve iu ka tërhequr edhe një here vërejtjen me pasojat e pranimit te fajësisë dhe faktin se me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurve të pandehurit nuk do te kenë mundësi te paraqesin prova e te kundërshtoj provat apo aktakuzën, te godas vendimin për konstatimin e gabuar e jo te drejte te gjendjes faktike, si dhe faktin se pranimi i fajësisë është rrethane lehtësuese me rastin e caktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit.

Edhe pas njoftimit nga gjykata për pasojat e pranimit te fajësisë, te pandehurit secili veç e veç kanë deklaruar se e ndiejnë veten fajtor dhe pendohen për veprën e kryer dhe atë që ka ndodhur edhe përkundër pasojave te pranimit te fajësisë.

Prokurori i shtetit ne shqyrtimin fillestar ka deklaruar se prokuroria pranon pranimin e fajësisë te te pandehurve sepse pranimi është vullnetar, pa resion dhe i bazuar ne provat nga shkresat e lendes, andaj i ka propozuar gjykatës qe te pranoj pranimin e fajësisë se te pandehurve.

Gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga te pandehurit dhe ka konstatuar se pranimi i fajësisë është ne përputhje me nenin 248 par.1 te KPK-se, se te pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë është bere me vullnetin e tyre te plote dhe se ky pranim mbështetet ne provat nga shkresat e lendes dhe atë: raporti i oficerit dt. 11.10.2009, deklarata e të akuzuarit te pare Sh. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e te pandehurit B. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e te pandehurit Sh. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e te dëmtuarit I.Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e dëshmitarit S. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e dëshmitarit F. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e dëshmitares E. Sh. dt. 11.10.2009; deklarata e te pandehurit F.Sh. dt. 11.10.2009; procesverbali mbi bastisjen dt. 11.10.2009; fotodokumentacioni ne katër shtojca; memorandum i zyrtar i dt. 27.04.2011; raporti plotësues i dt. 12.10.2009; dhe raporti i ekspertizës dt. 31.03.2011 ne katër shtojca.

Gjykata vlerëson se te gjitha këto prova nga shkresat e lendes vërtetojnë faktin se të pandehurit kanë kryer veprën penale qe iu vihet ne barre e ne anën tjetër vete të pandehurit kanë deklaruar se e pranojnë fajësisë dhe se e ndiejnë veten fajtor.

Dispozitat e nenit 328 par 1 te KPK-së kane parapa se: Kushdo që përdor apo vringëllon armët me frikësim, kërcënim ose në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar apo urdhëron personin tjetër të veprojë në mënyrë të njëjtë dënohet me gjobë deri në 10,000 euro ose me burgim prej një deri në dhjetë vjet.

Gjykata lidhur me **llojin dhe lartësinë e dënimit** ne zbatim te rekomandimeve edhe te gjykatës se Apelit, për te akuzuarin Sh. Sh. ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese ne baze te nenit 64 te KPK-ës. Si rrethane lehtësuese gjykata çmoi pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ne shqyrtimin gjyqësorë, pendimin e tij te shprehur para gjykate, se ndaj te pandehurit nuk zhvillohet procedure tjetër penale dhe fakti se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një periudhe relativisht e gjate por qe i pandehuri nuk paraqitet si kryes i ndonjë vepre tjetër.

Kurse si rrethane renduese gjykata e vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Gjykata ne rastin konkret si rrethane renduese ka vlerësuar edhe faktin se i pandehuri Sh. Sh. ka demonstruar dhune e kanosje ndaj te dëmtuarve dhe se të njëjtit kanë qene të kanosur edhe me përdorim te armës te cilën i pandehuri e kishte përdorur me qellim frikësimi, kurse ne veçanti gjykata vlerësoi si rrethanë renduese mënyrën e kryerjes se veprës penale dhe faktin se arma iu ishte drejtuar pjesëtareve te policisë gjatë kryerjes se detyrës zyrtare.

Gjykata lidhur me **llojin dhe lartësinë e dënimit** ne zbatim edhe te rekomandimeve te gjykatës se Apelit për te akuzuarin F. Sh. ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese ne baze te nenit

64 te KPK-ës. Si rrethane lehtësuese gjykata çmoi pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ne shqyrtimin gjyqësorë, sjelljen e tij ne gjykate e cila ka qene korrekte, se ndaj te pandehurit nuk zhvillohet procedure tjetër penale e si rrethane renduese gjykata e vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra dhe sidomos konsideroj faktin se vepra penale ka qen e drejtuar kundër pjesëtareve te policisë se Kosovës.

Gjykata vlerësoi se ne rastin konkret duhet te zbatohen dispozitat e nenit 67 te KPK-së dhe te pandehurve të iu zbutet dënimi gjithnjë duke u bazuar ne rrethanat lehtësuese te cilat u përshkruan më sipër dhe sidomos faktin se te pandehurit kanë shpreh pendim për veprën e kryer, kane pranuar fajësinë sipas aktakuzës dhe se nga koha e kryerjes se veprës ka kaluar një periudhë relativisht e gjate andaj çfarëdo sanksioni tjetër penal po të iu shqiptohej të akuzuarve nuk do të mundë të kishte efekt të dobishëm për risocializimin e tyre.

Gjykata vlerëson se me dënimin e shqiptuar ndaj te pandehurve do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat e nenit 34 te KPK-ës, pasi qe me këtë dënim te shqiptuar ndaj te pandehurve arrihet qëllimi i dënimit; parandalimi i kryesve nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen dhe rehabilitimi i tyre si dhe efekti preventiv ndaj personave te trete.

Andaj ne baze te dispozitave te nenit 365 te KPPK-ës, gjykata vendosi qe te akuzuarit Shaban Shabani e Fitim Shabani ti shpalle fajtor për veprën penale e cila iu vihet ne barre, sepse u provua se kanë kryer veprën penale për te cilën akuzohen, dhe gjykata ka konstatuar se ekzistojnë elementet e veprës penale, e cila i vihet ne barre te pandehurve, ashtu që ne baze te pranimit te fajësisë dhe provave nga shkresat e lendes atë e shpalli fajtor dhe ne rastin konkret zbatoj dispozitat ligjore te nenit 365 te KPP-ës.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve si dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Së këndejmi duke konsideruar edhe rekomandimet e gjykatës se Apelit, me pranimin e të gjitha këtyre rrethanave, nuk ka pasur vend që të pandehurve Sh. Sh. e F. Sh. të iu shqiptohet ndonjë dënim tjetër më i rëndë apo më i butë.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin, gjykata e morri konform nenit 450 par 1 lidhur me par.2 nen par. 2.6 te KPRK-se.

Vendimi mbi pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 39 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin mbi udhëzimin e te dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e morri ne përputhje me nenin 463 par.2 te KPP-se.

Andaj nga arsyet e lartcekura e në baze te nenit 3, 11, 34, 38, 65, 67 te KPK –së dhe nenit 328, par 1 te KPK-se gjykata ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal
P.nr. 230/22 dt. 12.08.2022

Numri i lëndës: 2019:120119
Datë: 12.08.2022
Numri i dokumentit: 03322724

Zyrtarja Ligjore
Nazmije Maxhera

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditë gjykatës se Apelit ne Prishtine e nëpërmes kësaj gjykate.